

VENDIM
Nr.814, datë 29.11.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.663, DATË 18.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RISHPËRNDARJEN E FONDIT TË KONTIGJENCËS, TË
PARASHIKUAR NË BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2007”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.663, datë 18.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 900 000 000 (nëntëqind milionë) lekësh, nga të cilat:

i) 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, në programin “Policia e Shtetit”, zëri “Investime për blerje automjetesh”;

ii) 800 000 000 (tetëqind milionë) lekë, në programin “Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor”, zëri “Investime për infrastrukturën vendore për objektet në proces”. ”.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Investime”. ”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha